



## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **25.02.2026**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**. Kryesuesi konstatoi se, kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 27 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 27.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, sekretari e kuvendit zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie dhe ju të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Kjo është mbledhja e **dytë** e rregullt e legjislaturës 2025-2029 dhe në bashkëpunim me kryetarin kemi vendosur për këtë:

### REND DITE

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/206 Nr. i faq/Br.str/No.pg 85

Data/Datum/Data 24.03.2026

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “KRM Ekoregjioni” në Rahovec;
3. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” në Rahovec;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP);
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për organizimin e brendshëm, sistemimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Rahovecit;
6. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026;
7. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-05058-0 ZK-Rahovec;
8. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-08152-0 ZK-Rahovec;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të pjesë së parcelës P-71510057-02240-80, ZK-Rahovec;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social P-71510057-02172-1, zona kadastrale Rahovec;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për emërimin e delegatëve të Kuvendit të Komunës në Rahovec, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK);
12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr. prot. 01 Nr. 181/24, të datës 30.1.2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 20/25, të datës 28.2.2025, për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit ad hoc për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkurruar për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 84/26, të datës 26.1.2026, për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete;

15. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, P-71510033-00772, ZK-Xërxë;
16. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025;
17. Shqyrtimi i informatës së KKSB-së për vitin 2025;
18. Shqyrtimi i kërkesës së Kompanisë Regjionale për Mbeturina “Ekoregjioni”, për ngritjen e tarifës së shërbimit të mbeturinave;
19. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

**Kryesusi:** Atëherë, pas leximit të rendit të ditës prej 19 pikave, po e hapim debatin. A e keni pranuar materialin me kohë, nëse dikush ka vërejtje?

**Vlora Vuçitërna:** Unë nuk e kam pranuar materialin fizik.

**Skender Hamza:** Kuvendarët që kanë laptopë, nuk e pranojnë materialin fizik, por vetëm asamblistët e ri që ende nuk janë të pajisur me laptopë.

**Defrim Kafexhiu:** I nderuari kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë anëtarë të Kuvendit. Pika e fundit e rendit të ditës (pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve), propozoj që të kalojë si pikë e dytë e rendit të ditës. Të njëjtën gjë kemi kërkuar edhe në seancën e kaluar dhe me mirëkuptim të kalojë si pikë e dytë e rendit të ditës, duke marrë parasysh që në seancat e tilla sikurse kjo e sotmja, nuk mund të ketë as vullnet e as produktivitet në diskutimet e anëtarëve të Kuvendit. Si pozitë, ju e keni shumicën tani. Ne mund vetëm ta diskutojmë dhe ta vendosim në votim, por në fund ju përsëri, përmes votave, mund ta vendosni si pikë të fundit. Nëse është e nevojshme, do të tentoj në çdo fillimseancë ta bëj këtë propozim, 4 vjet me radhë. Ka qenë një standard i mirë në mandatin e kaluar.

**Lirigzon Kastrati:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, drejtorë, kolegë anëtarë, qytetarë të pranishëm. Kërkoj nga ana juaj që në fund të seancës të na vije një informatë nga DKA-ja ose të përfshihet në rend dite tani, në seancën e radhës, apo në pikën “pyetje dhe përgjigje”, të na njoftojë se ku janë mungesat e kuadrit profesional, të matematikës dhe të fizikës? Të na njoftojë për gjendjen e mësimdhënësve me normë të plotë, si dhe për ata që janë me gjysmë norme. Sipas informacioneve nga ekzekutivi, mbi 186 mësimdhënës janë më tepër dhe këtu po e shohim që komuna ka shpallur konkurs për mësimdhënës në arsimin fillor.

**Enis Durguti:** Përshëndetje për të gjithë! E di që është rendi i ditës pak i ngarkuar, por propozoj edhe një komision. Komisioni për diasporë, sepse është mjaft i rëndësishëm. Së fundmi, e kemi parë një skandal nëpër medie sociale kredibile dhe pak besimi është humbur nga diaspora sa iu përket investimeve në komunën e Rahovecit. Propozoj që të formohet një komision, të vendoset në rend dite, i cili punon me diasporën nga komuna e Rahovecit, si dhe të fitohet besimi i mërgimtarëve tanë për investime në komunën tonë.

**Kryetari:** Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, anëtarët e Kuvendit, medie, përfaqësuesit e KFOR-it dhe të OSBE-së! Në qoftë se, kuvendi ka vendosur që një pikë të jetë e fundit, besoj që është vendim i Kuvendit. Në emër të qytetarëve, kjo pikë është mirë që është e fundit, sepse ka shumë pika më të rëndësishme para kësaj pike, sepse të gjitha janë vendime. E sugjeroj Kuvendin që nuk ka nevojë të përsëritet operacioni, sepse kështu do të jetë gjatë këtij mandati për 3 vjet e 10 muaj. Nuk mund ta relativizojmë vendimmartjen në Kuvend, vetëm për dëshirën e disave që kanë dëshirë të dalin në fotografi. Le të mbetet kështu, sepse serioziteti i kuvendarit matet edhe me përkushtimin se a do të qëndrojë deri në fund, apo jo. Sa i përket komisionit për diasporë, nuk ka pikë shtesë, por nëse vendos Kuvendi, atëherë duhet të ketë. Meqenëse është i ngarkuar rendi i ditës, nuk ka nevojë. Në rend dite mund të shtojmë pika shtesë vetëm kur të kemi diçka nga MAPL-ja. Sa i përket komisionit për diasporë, këtë e bën ekzekutivi, por mund ta bëjë edhe Kuvendi. Rreth asaj që ka humbur besimi i diasporës, nuk ka instrument që e mat. Nëse ka dikush ndonjë matje, në seancën tjetër le ta paraqesë në Kuvend dhe ia propozon Kuvendit të Komunës formimin e komisionit, të cilin nuk e kuptoj se çfarë

është dhe arsyetimi që u dha absolutisht është i paqëndrueshëm. Sa i përket pyetjes rreth DKA-së: Ju lutem, drejtori i Arsimit le të përgatitet për seancën tjetër.

**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! Një sqarim: Pika “pyetjet dhe përgjigjet”, çdo herë ka qenë e fundit, përveç në mandatin e kaluar si pikë e dytë. Realisht, unë si kryesues, e kam obligim ta vendos në votim secilin propozim të secilit kuvendar. Nëse doni e vendos, por në secilën seancë do të ishte e kotë, sepse paraprakisht mund ta dini verdiktin e saktë për këtë pikë të rendit të ditës. Ju, shefat e grupeve, mund të dakordoheni dhe nëse arrini ndonjë konsensus, atëherë mund ta vendosim si pikë të dytë të rendit të ditës. Komisioni i diasporës - kjo duhet të ndodhë në bashkëpunim me ekzekutivin. Rreth kësaj do të ketë diçka në statut, kështu që të mos ngutemi dhe të krijojmë konflikte interesi. Lirigzon, rreth pyetjes suaj, e ftoj drejtorin e Arsimit që për seancën e marsit të përgatisë një pikë të veçantë të rendit të ditës. Po e vendos në votim rendin e ditës, kush është “për”?... kundër?... abstenim?... Me 23 vota, miratohet rendi i ditës për sot.

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** Besoj që procesverbalin e keni lexuar dhe nëse eventualisht keni ndonjë gjë rreth procesverbalit? Nëse jo, po e vendos në votim. Kush është “për”?... kundër?... abstenim?... Miratohet unanimisht pika e parë.

### **2. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “KRM Ekoregjioni” në Rahovec:**

**Kryesuesi:** Këtu e kemi një asamblist, Mentor Veliu, i cili është drejtor i kësaj organizate dhe sipas ligjit, ai mund të jetë pjesëmarrës në diskutim, mirëpo gjatë votimit e lus që ta lirojë sallën.

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje kryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të Kuvendit, të pranishëm! Sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike, po ashtu edhe Ligjit për Shoqëri Tregtare, është rregull që çdo herë kur bëhet kuvendi i ri komunal, duhet të formohet komisioni i aksionarëve dhe sipas ligjit, duhet të jenë 2 anëtarë të Kuvendit dhe 1 anëtar i ekzekutivit.

**Berat Duraku:** Faleminderit, kryesues! Anëtare për këtë komision e propozojmë Florida Bajraktarin.

**Lirigzon Kastrati:** E propozojmë asamblistin Hazbije Shala.

**Vlora Vuçiterna-Omega:** Nga Lëvizja Vetëvendosje nuk kemi propozim.

**Melinda Oruqi-Iska:** Nga PDK-ja propozojmë Flutura Thaqin.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Meqenëse i kemi tre propozime dhe na duhen vetëm dy, atëherë duhet t'i vendosim në votim. Kush është “për” Florida Bajraktarin?... kundër?... abstenime?... Kush është “për” Hazbije Shalën?... kundër?... abstenime?... Kush është “për” Flutura Ukaj Thaqi?... kundër?... abstenime?... Ju njoftoj që Florida i mori 14 vota, Flutura 14 dhe Hazbije Shala 12.

**Kryetari:** Nga ekzekutivi, Përparim Krasniqi – Drejtor i Shërbimeve Publike.

**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! Atëherë, tani i kemi tre anëtarë për këtë komision. Kush është “për”?... kundër?... abstenime?... Me 14 vota miratohet ky vendim.

### **3. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” në Rahovec:**

**Berat Duraku:** Nga AAK, propozojmë Lendrit Morinën.

**Lirigzon Kastrati:** Në këto komisione po shihet që pozita i ka numrat dhe asnjë propozim i opozitës nuk kalon. Kshtu që nuk kemi propozim.

**Vlora Vuçiterna-Omega:** As Lëvizja Vetëvendosje nuk ka propozim. Meqenëse pozita i ka numrat edhe nuk po e hapin zemrën as në këtë muaj të shenjtë të Ramazanit.

**Melinda Oruqi-Iska:** Grupi i PDK-së e propozon Mirsad Shehun.

**Kryetari:** Unë e propozoj Përparim Krasniqin – Drejtor i Shërbimeve Publike.

**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! Tani i kemi 3 emra për këtë komision dhe shpresoj që MAPL-ja do të na kthejë ligjshmërinë edhe pse, nëse kërkohet kuota gjinore, këtu nuk e kemi respektuar. Pra, Lendrit Morina, Mirsad Shehu

dhe Përparim Krasniqi. Kush është “për”?... kundër?... abstenime?... Me 15 vota “për” dhe 1 kundër, kalohet ky vendim.

#### **4. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP):**

**Muhamet Morina:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, drejtoresha! Të respektuar asamblistë dhe ju të pranishëm! Para jush e kemi kërkesën e DKA-së, për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore në komunën e Rahovecit. Për anëtarë të komisionit e kemi përcaktuar një zyrtar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, Lulëzim Krasniqi (kryesues) dhe anëtare është Shemsije Shala – drejtoreshës e ShFMU “Heronjtë e Zatriqit” në Zatriq. Disa fjalë për kompetencat e këtij komisioni: Përzgjedhja prej dy anëtarëve është kompetencë e jona, të njëjtit i plotësojnë kushtet që të bëjnë vlerësimin e drejtorëve ose kandidatëve që do të aplikojnë për drejtorë të këtyre shkollave. Komisioni ka për detyrë që t’i intervistojë kandidatët që kanë konkurruar në konkursin e cekura në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe në bazë të pikëve të fituara, bëhet renditja e kandidatëve. Lista e kandidatëve që kanë më shumë pikë përcillet te kryetari, i cili bën emërimin e tyre si drejtorë. Komisioni në fjalë duhet ta ketë edhe anëtarin e tretë, të cilin e përcakton Ministria e Arsimit. Komisioni është i obliguar që punët t’i kryejë duke u bazuar në ligjet dhe në aktet nënligjore në fuqi. Mandati i komisionit përzgjedhës është 1 vit. Pas miratimit nga Kuvendi, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 9 të ligjit 08/L-284, për shqiptimin administrativ të akteve të komunës dhe 7 ditë pas shpalljes publike në faqen ueb zyrtare të komunës.

**Kryesuesi:** Ashtu siç e prezantoi drejtori, ne veçse i kemi dy emra të komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe brenda një viti kalendarik, aq sa ka afat ky komision, do të kujdeset për konkurse të tilla. Kush është “për”?... kundër?... abstenime?... Me 22 vota miratohet ky vendim.

#### **5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullore për organizimin e brendshëm, sistemimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Rahovecit:**

**Mirsad Shala:** Faleminderit, kryesues! Prezantimin e kësaj rregulloreje po e bëj në cilësinë e anëtarit të grupit punues. Atëherë, Qeveria e Republikës së Kosovës, me vendimin Nr. 08/86, të datës 23 tetor 2024, ka miratuar katalogun e vendeve të punës të shërbimit civil, me të cilin i ka obliguar të gjitha institucionet që të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës, në përputhje me rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës. Pas kësaj, kryetari i Komunës, më datë 14 nëntor 2024, me vendim e ka caktuar grupin punues, në përbërje prej 7 anëtarëve, për hartimin e rregullore. Nga kjo datë, grupi punues, në bashkëpunim me Njësinë e Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit, ka hartuar rregulloren, e cila në vija të trasha ka qenë e hartuar nga Kolegjiumi i Njësisë i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës. Pas përfundimit të draftit të parë, që e kemi bërë në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive, duke u bazuar në Ligjin për Zyrtarë Publikë dhe në rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës për klasifikimin e vendeve të punës, Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit, më datë 26 nëntor 2025, ka dërguar këtë draft-rregullore për shqyrtim në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DPMZP), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Më datë 16 dhjetor 2025, ky departament ka kthyer përgjigje, duke na dhënë disa rekomandime, të cilat, ne si grup punues i kemi inkorporuar në këtë rregullore. Duke u bazuar në legjislationin në fuqi, kemi mbajtur diskutimin publik ku e kemi prezantuar rregulloren para zyrtarëve të komunës, duke i njoftuar ata në detaje dhe njëkohësisht u kemi dhënë edhe përgjigje në pyetje të tyre. Në fund, ju njoftoj se të premten ka ardhur edhe një propozim nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në koordinim me Kryetarin e Komunës. Propozimi duke të shqyrtohet nga ju dhe më pas edhe të votohet. Drejtoria në fjalë ka kërkuar që Sektori për Turizëm të ndahet nga Sektori i

Ekonomisë dhe i Zhvillimit. Këtu, zyrtarja për turizëm, e cila deri më tani ka qenë e përfshirë në Sektorin për Ekonomi dhe Turizëm, tani do të bartet në Sektorin për Turizëm dhe njëkohësisht këtu shtohet udhëheqësi i sektorit, si dhe një zyrtar për turizëm në kategorinë profesionale 2. Në fund, dua t'ju njoftoj që për t'u implementuar kjo rregullore, e ka koston e saj financiare, ku komuna e ka paraparë në buxhet dhe të njëjtin e ka miratuar në shtator të vitit të kaluar.

**Lirigzon Kastrati:** Përveç Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik që ndahet në dy sektorë, drejtoritë e tjera a ndahen? Drejtoria e Financave?

**Berat Duraku:** E falënderoj kryetarin, bashkë me ekzekutivin për përpilimin e kësaj rregulloreje, që ndikon direkt në rregullimin e pozitave të punës për shërbyesit civilë, sepse e meritojnë të trajtohen barabartë.

**Defrim Kafexhiu:** I kam disa pyetje: Pyetja e parë është te avokati i komunës. Kush cilësohet avokat i komunës prej zyrtarëve të komunës? Nëse cilësohen zyrtarët e Zyrës Ligjore, atëherë, pse komuna duhet ta kontrakttojë një avokat nga jashtë, për ta mbrojtur komunën nëpër procese gjyqësore. Te kuvendi nuk ka diçka te kjo rregullore. Ndoshta ka mundur të bëhet një sistemim, të paktën strukturën organizative nuk e kam hasur. Kuvendi i Komunës e ka edhe sekretarinë dhe nuk e di a është e përfshirë këtu. Si është e sistemuar sekretaria e Kuvendit në këtë draft-rregullore? Përndryshe, është mirë që po bëhet kjo rregullore dhe është një hap shumë i mirë.

**Mirsad Shala:** Lirigzon, me kërkesën e drejtorit për Buxhet dhe Financa, e kemi ndarë një sektor, d.m.th. Sektori për Buxhet dhe Financa. Tani, me kërkesë të drejtorit, i kemi ndarë këto dy sektorë, për Buxhet, si dhe për Financa. Këtu, drejtori nuk ka paraparë pozita shtesë, por vetëm bartjen e disa zyrtarëve prej njërit sektor në tjetrin. Avokati i komunës është pozitë e veçantë, tani e ka ndarë edhe ligji për paga. Ligji për avokaturën shtetërore, avokatët i ka ndarë në avokatë shtetërorë dhe në avokatë komunalë. Departamenti i ministrisë na ka propozuar që avokati i komunës t'i raportojë drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës, mirëpo, përderisa avokati ka shumë lëndë, ka lindur si ide që të formojmë sektorë dhe në kuadër të zyrës së përfaqësimit ligjor do të jenë: udhëheqësi i zyrës, avokati dhe dy zyrtarë ligjorë. Për momentin, Komuna nuk ka avokat, mirëpo, është në diskrecion të Kryetarit të autorizojë ndonjë zyrtar komunal, që ta përfaqësojë Komunën në procedura gjyqësore. Sa i përket Sekretarisë së Kuvendit, me këtë rregullore është nën administratë, sepse kështu ka qenë edhe më herët. Me kërkesë të Kryetarit dhe me aprovim nga drejtori për Buxhet dhe Financa, janë shtuar tri pozita të punës për trashëgimi kulturore për muzeun e Krushës së Madhe dhe në Gradish, në përgjithësi për trashëgimi kulturore.

**Defrim Kafexhiu:** Nuk e di a më lejohet të bëj propozime për këtë rregullore, nëse po, atëherë rekomandoj që të neni i 6 ku përcaktohet Kuvendi i Komunës, në të njëjtin sektor të përfshihet edhe Sekretaria e Kuvendit. Një pyetje tjetër për kryetarin: Sa është kostoja totale e këtij sistemimi dhe i këtyre ndryshimeve?

**Kryesuesi:** Para se ta marrë fjalën kryetari, gjithashtu edhe unë i kam dy pyetje: në faqen nr. 29, në tabelën me nr.1, a duhet të përfshihet asistenti i kryesuesit? - Pyetja e dytë: A kemi të drejtë të formojmë sektorë të rinj në drejtori të caktuara?

**Mirsad Shala:** Po, patjetër, mund të bëhen edhe propozime të tjera nga ju. Gjithashtu, mund të formohen edhe sektorët, veç duhet të merret parasysh kostoja financiare. Asistentja administrative është te Kabineti i Kryetarit, por gjithsesi, nëse e sheh të nevojshme, mund ta bartim te pjesa e Kuvendit.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Mirsad! Le të jetë bashkë me kryesuesin edhe asistenti i kryesuesit.

**Kryetari:** Sipas kësaj projekt-rregulloreje për sistematizimin e vendeve të punës, është e rëndësishme të theksohet se gjithë ky proces ka kosto financiare 250.000-270.000 brenda vitit. Është integruar parimi i mosdiskriminimit për të gjithë zyrtarët. Kjo rregullore është në koordinim me departamentin përkatës dhe në përputhshmëri me rregulloret e Asociacionit të Komunave të Kosovës, duke u trajtuar të gjitha çështjet, si dhe parimet e kushteve të njëjta dhe të barazisë. Kërkoj miratimin e rregullores, me plotësim-ndryshimin që e bëri kryesuesi dhe njëkohësisht edhe shtesën që e ka bërë Mirsadi, sa i përket Sektorit për Turizëm. Te avokati i komunës: Fillimisht është pranuar kandidatja e më pas është liruar, sepse e njëjta është bërë gjyqtare. Për të qenë avokat i Komunës, duhet ta kesh

provimin e jurisprudencës. Sekretaria e Kuvendit, mendoj që duhet të qëndrojë në Administratë, për shkak të pagave, sepse nuk mund t'i paguajmë nga fondi i Kuvendit.

**Lirigzon Kastrati:** Sa i përket temës së avokatit të komunës, një pyetje për Mirsadin, por edhe për ekzekutivin. Deklarove që Komuna nuk ka avokat. Kush e ka përfaqësuar interesin e Komunës në instanca ligjore? The që zyrtari ligjor, me autorizim. Te detyrat dhe përgjegjësitë (neni 10), zyrtari ligjor nuk e përfaqëson Komunën. Sa kohë është Komuna pa avokat?

**Jusuf Dërmala:** Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë! Brenda kësaj rregulloreje do të ishte mirë të inkorporohet edhe performanca e punëtorëve – vlerësimi i performancës së punëtorëve, nëse është e mundur ligjërisht të përfshihet këtu.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Jusuf! Dua të ndërlidhem te formimet e sektorëve. A është në kundërshtim me statutin e komunës dhe a duhet që paraprakisht të ndodhë plotësim-ndryshimi i statutit?

**Kryetari:** E para, performanca e secilit punonjës publik është obligim dhe detyrim ligjor, pra, nuk ka nevojë të jetë në statut. Ligji e thotë që ne obligohemi deri më 31 janar të bëjmë vlerësimin e të gjithë punëtorëve dhe ne e kemi bërë. Mendoj që është diçka e panevojshme, që vlerësimi i performancës së punëtorëve të përfshihet në rregulloren e organizimit të brendshëm për sistematizimin, klasifikimin dhe organizimin e shërbimit civil në Komunën e Rahovecit. Koncepti i kësaj rregulloreje është krejt diçka tjetër. Te përfaqësimet ligjore: Kryetari ka kompetencë ta caktojë cilindo zyrtar ligjor, që ta përfaqësojë Komunën e Rahovecit në çështje gjyqësore. Në këtë rast, për çështje ligjore është Valmir Gashi, në Gjykatën Themelore në Degën e Rahovecit dhe në Gjakovë. Ka 10 vjet që Komuna e Rahovecit nuk ka avokat, ushtrues detyre ka pasur dhe ka qenë Bylbyl Oruçi. Komuna jonë ka nevojë për një avokat dhe shpresojmë që të kemi rrethana të përshtatshme që ta hapim një konkurs.

**Mirsad Shala:** Kryesues, në statutin e Komunës nuk janë të paraparë sektorët, por vetëm drejtoritë dhe për këtë arsye është rregullorja për organizim të brendshëm, e cila i ndan sektorët e gjithë tjetër. Jusuf, procedura e performancës dhe e vlerësimit të zyrtarëve publikë është e ndarë nga kjo. Ky klasifikim ka ardhur si rezultat që më herët ka pasur emërtime të ndryshme. Një rast: në komunë ka qenë edhe zyrtari i kontrolleve teknike dhe në katalogun e ri nuk ekziston. Këtu është sistematizuar vendi i punës dhe jo performanca. Nëse një zyrtar ka punuar në Drejtorinë e Ekonomisë dhe puna e tij ka qenë e aspektit financiar, me sistematizim, ai bartet te Drejtoria e Financave. Lirigzon, ka raste që edhe unë shkoj në përfaqësim në raste gjyqësore dhe përderisa nuk ka avokat, autorizimi është në diskrecion të kryetarit.

**Kryesuesi:** Nëse nuk ka dikush tjetër diçka, unë po e vendos këtë rregullore në votim. Kush është “për”?... kundër?... abstenim?... Në mënyrë unanime votohet kjo rregullore. Ju falënderoj!

#### **6. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026:**

**Skender Hamza:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Plani i punës i kuvendit për vitin 2026 është i hartuar në bazë të detyrave dhe të përgjegjësisve që dalin nga ligji për vetëqeverisje lokale, statute dhe aktet e tjera nënligjore. Më datë 10 shkurt 2026, anëtarët e KPPF-së, së bashku me ekzekutivin dhe disa udhëheqës të disa sektorëve, kanë mbajtur një punëtori dhe e kanë përgatitur një plan të punës që sot e keni para vetes. Me këtë plan, Kuvendi Komunal i Rahovecit planifikon t'i mbajë 12 seanca të rregullta, secilin muaj nga një. Të nderuar kuvendarë, Sekretaria e Kuvendit është e hapur për çdo pyetje dhe çdo propozim tuajin.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit, Skendo! Nuk e dëgjova mirë, nëse e ke përmendur vizitën studimore sipas planit, gjatë vitit 2026?

**Kryesuesi:** Po, është në plan.

**Kryesuesi:** Nëse nuk ka dikush tjetër diçka, unë po e vendos në votim. Kush është “për”?... kundër?... abstenim?... Në mënyrë unanime, votohet plani i punës së Kuvendit për vitin 2026. Me propozim të Lirigzonit, shkojmë në pauzë dhe shihemi në orën 13:00.

**Kryesuesi:** Të nderuar kolegë, para se të fillojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës, e kemi një informatë nga Bashkësia Islame, e cila më 1 mars (e diel) e organizon një iftar. Ftesa është për gjininë mashkullore, ndërsa për gjininë femërore, me gjasë do ta organizojë një iftar tjetër. Kështu e kam informatën.

**7. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-05058-0, ZK-Rahovec:**

**Besmire Bytyqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të Kuvendit. Para jush e keni propozim-vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. I njëjti komision është formuar edhe në mandatin e kaluar, por tani duhet ta ndërrojmë, meqenëse tani kemi ndryshime në legjislativin dhe ekzekutivin e komunës. Parcela gjendet te rruga transite në zonën kadastrare në Rahovec.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtoreshë! Në këtë komision do të përfshihen 2 anëtarë nga ekzekutivi, 2 nga Kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

**Berat Duraku:** Nga AAK-ja, për këtë komision e propozojmë Mentor Durgutin.

**Lirigzon Kastrati:** Nga LDK-ja nuk kemi propozim.

**Vlora Vucitërna:** Nga LVV-ja propozojmë Bujar Mustafën.

**Melinda Iska:** Nga PDK-ja, në këtë komision e vendosim Behlul Krasniqin.

**Kryesuesi:** Një sugjerim në cilësinë e kryesuesit, jepni edhe emra të gjinisë femërore ose në këtë rast realisht prej sektorit joqeveritar duhet të jetë femër. Shkojmë në votim me propozimet e bëra. Kush është “për” Mentor Veliun?... kundër?... abstenime?... Kush është “për” Bujar Mustafën?... kundër?... abstenime?... Kush është “për” Behlul Krasniqin?... kundër?... abstenime?... Atëherë, Mentor Veliu 13 pro, Bujar Mustafa 12 pro dhe Behlul Krasniqi 14 pro. Kështu që, Mentor Veliu nga AAK-ja dhe Behlul Krasniqi nga PDK-ja do të jenë dy anëtarë të këtij komisioni nga Kuvendi. Kërkojmë edhe nga kryetari dy emra.

**Kryetari:** Afrim Oruqi dhe Besmire Bytyqi, si dhe Adelinë Paqarizi.

**Kryesuesi:** Atëherë, ne veç i kemi emrat dhe po e vendos në votim këtë komision. Kush është “për”?... kundër?... abstenim?... Me 14 vota pro formohet ky komision.

**8. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-71510057-08152-0 ZK-Rahovec:**

**Besmire Bytyqi:** Njëjtë sikurse në pikën e tetë të rendit të ditës, edhe këtu po kërkojmë ta formojmë komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vjet. Komisioni ka qenë funksional, mirëpo tani duhet ta ndërrojmë, sepse kemi ndryshime në legjislativin dhe në ekzekutivin e komunës. Parcela gjendet në rrugën transite në zonën kadastrare në Rahovec, pjesa e quajtur Rimnik, me sipërfaqe prej 2762m<sup>2</sup>.

**Kryesuesi:** Përsëri duhet t'i zgjedhim 5 anëtarë, dy prej tyre nga Kuvendi.

**Berat Duraku:** Nga AAK-ja, për këtë komision e propozojmë Ruzhdi Morinën.

**Lirigzon Kastrati:** Nga LDK-ja nuk kemi propozim.

**Defrim Kafexhiu:** Nga LVV-ja propozojmë Zana Çantën.

**Melinda Iska:** Nga PDK-ja, në këtë komision e propozojmë Mirsad Shehun.

**Kryesuesi:** Kush është “për” Ruzhdi Morinën?... kundër?... abstenime?... Kush është “për” Zana Çantën?... kundër?... abstenime?... Kush është “për” Mirsad Shehun?... kundër?... abstenime?... Atëherë, Ruzhdi Morina ka 14 pro, Zana Çanta 12 pro dhe Mirsad Shehu 14 pro. Kështu që, Ruzhdi Morina nga AAK-ja dhe Mirsad Shehu nga PDK-ja, do të jenë dy anëtarë të këtij komisioni nga Kuvendi. Meqenëse kryetari nuk është këtu, kërkoj nga nënkryetari dy propozime nga ekzekutivi.

**Jusuf Dërmala:** U përmend se kjo pronë është në Rimnik, por në bazë të gjeoportalit, kjo pronë është në Hamoc.

**Besmire Bytyqi:** Me dokumentacionin e pranuar nga zyrtarët e Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi, kjo pjesë është në Rimmik, mirëpo veç nëse është ndonjë gabim teknik. Faleminderit! Do ta rishikojmë.

**Kryesuesi:** Meqenëse ende nuk ka propozime nga ekzekutivi, sepse kryetari nuk është këtu, atëherë ne mund ta autorizojmë kryetarin që t'i propozojë emrat më pas. Nëse dakordoheni, po e vendos në votim këtë vendim. Kush është "për"?... kundër?... abstenim?... Me 14 vota pro miratohet ky vendim.

**9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të pjesë së parcelës P-71510057-02240-80, ZK-Rahovec:**

**Besmire Bytyqi:** E kemi propozim-vendimin për një pjesë të parcelës 02240-80, ZK-Rahovec dhe pikërisht bëhet fjalë për parcelën të "Maja e Shkodranit". Po kërkojmë që ta shpallim në interes të përgjithshëm pjesën prej 148m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 751 ha e 24 ari. Qëllimi: Hapja e rrugës publike në qytet.

**Kryesuesi:** Në cilën pjesë të qytetit bëhet kjo hapje e rrugës?

**Besmire Bytyqi:** Kjo parcelë komunale gjendet të "Maja e Shkodranit".

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtoreshë! Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendos në votim. Kush është "për"?... kundër?... abstenime?... Me 14 vota pro, miratohet ky vendim.

**10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social P-71510057-02172-1, Zona Kadastrale Rahovec:**

**Albnor Mullabazi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, asamblistë! Para jush e keni vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social dhe të përballueshëm. Lokacioni është në parcelën 02172-1, ZK – Rahovec, me sipërfaqe 2261m<sup>2</sup>. Komuna e Rahovecit ka aplikuar në thirrjen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe është shpallur fituese për ndërtimin e objektit për banim social dhe me kërkesë të departamentit të ministrisë, kërkohet që me Kuvend të jepet vendimi për këtë lokacion.

**Lirigzon Kastrati:** E mirëpresim një vendim të tillë dhe natyrisht, në emër të grupit, e përkrahim.

**Defrim Kafexhiu:** Duke e prezantuar pikën drejtori i Urbanizmit, m'u kujtua një video në kohë fushate që e ka bërë ish-drejtori i Gjeodezisë dhe Kadastrës, Afrim Oruqi. Tani ky vendim po bëhet realitet, kurse ai ka dalë atje në terren, duke u treguar qytetarëve të Rahovecit që ky investim nuk po bëhet.

**Kryetari:** Afrim Oruqi ka qenë drejtor i Gjeodezisë dhe atëherë kur e ka bërë videon, është e vërtetë që komuna jonë nuk ka qenë përfituese. Në thirrjen e dytë është rikthyer kjo pikë, mirëpo është shumë e rëndësishme që Afrim Oruqi është përsëri drejtor dhe ti mbetesh asamblist.

**Kryesuesi:** Tash vetëm mbetet të shihet nëse realizohet ose jo! Nëse nuk ka diskutues të tjerë, vendimin po e vendos në votim. Kush është "për"?... a ka votë kundër?... abstenime?... Në mënyrë unanime miratohet ky vendim.

**11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për emërimin e delegatëve të Kuvendit të Komunës në Rahovec, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK):**

**Kryesuesi:** Nga asociacioni kanë kërkuar që të jenë dy anëtarë nga AAK-ja dhe një nga LDK-ja. Kjo është formula që aplikohet.

**Berati Duraku:** Nga grupi i AAK-së propozojmë, Sarandë Salltekun dhe Berat Durakun.

**Lirigzon Kastrati:** Meqenëse na takon një anëtar këtu si grupi më i madh opozitar, propozojmë Nehar Shalën.

**Kryesuesi:** Atëherë, delegatët e Kuvendit të Rahovecit për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës janë: Sarandë Sallteku dhe Berat Duraku nga AAK-ja dhe Nehar Shala LDK-ja. Kush është "për"?... kundër?... abstenime?... Me 23 vota miratohet ky vendim.

**12. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr. prot. 01 Nr. 181/24, të datës 30.1.2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 20/25, të datës 28.2.2025, për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit:**

**Kryesuesi:** Vendimin e keni para vetes, ndryshohet një anëtar.

**Skender Hamza:** Kuvendi i Komunës më datë 26 janar 2026, e ka marrë një vendim për formimin e komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarit të këtij komiteti. Në këtë përbërje kanë qenë: Qazim Cana, Zana Çanta, Behlul Krasniqi, Afrim Oruqi dhe Lulëzim Krasniqi. Në konkursin publik (15 ditor), kanë pasur të drejtë të aplikojnë të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit. Në këtë konkurs, kanë aplikuar 5 kandidatë. Pas shqyrtimit të kërkesave nga ana e komisionit, ky i fundit ka vendosur që anëtare e re të jetë Adelinë Shabandula.

**Kryesuesi:** Atëherë, kush është për këtë plotësim-ndryshim të vendimit? A ka votë kundër?... abstenime?... Me 17 vota “për” miratohet ky vendim.

**13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit ad hoc për shqyrtimin e kërkesave të kandidatëve që kanë konkurruar për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe:**

**Senad Mullaavda:** Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive! Të nderuar anëtarë të Kuvendit! Para vetes e keni vendimin që ka të bëjë me emërimin e anëtarëve për komisionin *ad hoc* për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe. Detyra e komisionit është që t’i shqyrtojë të gjitha aplikacionet dhe tutje ta përpilojë listën e kandidatëve që i kanë plotësuar kriteret. Gjithsej numri është 5: 2 anëtarë të Kuvendit dhe 3 janë të komunitetit serb. Komuniteti serb i ka dërguar emrat e 3 anëtarëve dhe tani i presim edhe 2 anëtarë nga Kuvendi.

**Lirigzon Kastrati:** Në thirrjen publike që e keni bërë, aty thotë se pagesa e anëtarëve të këshillit të fshatit është në proporcion me anëtarët e KPF-së, kjo do të thotë që nuk ka qenë e rregulluar sipas ligjit.

**Defrim Kafexhiu:** Në mbledhjen e KPF-së e kam ngritur si çështje. Në mandatën e kaluar, komisioni i ka përzgjedhur 6-7 anëtarë dhe kanë ardhur në Kuvend, tutje Kuvendi i ka zgjedhur anëtarët e këshillit të fshatit përmes votës. Kjo gjë nuk besoj që ka qenë e arsyeshme. Pra, duhet të formohet komisioni i cili i përzgjedh anëtarët e këtij këshilli. Komisioni duhet t’i zgjedhë 4 anëtarë dhe në Kuvend të vijnë si pako për miratim.

**Senad Mullaavda:** Çështja e pagave është e caktuar në vendim, duke u bazuar në ligjin e ri të pagave. Te puna e përzgjedhjes: Detyra e komisionit është që në fund ta dërgojë listën e përzgjedhur dhe të merituar të 4 kandidatëve për aprovim.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Senad! Sot kemi të bëjmë veç me formimin e komisionit dhe nga ju i kërkojmë propozimet.

**Berat Duraku:** Nga AAK-ja propozojmë Mentor Durgutin.

**Lirigzon Kastrati:** Nga LDK-ja propozojmë Qazim Canën.

**Defrim Kafexhiu:** Nga LVV-ja propozojmë Jusuf Dërmalën.

**Melinda Iska-Oruqi:** Nga PDK-ja propozojmë Behlul Krasniqin.

**Kryesuesi:** Në këtë rast i kemi 4 meshkuj, 4 propozime dhe të jeni të bindur që vendimi do të kthehet si jo i rregullt, për shkak të kuotës gjinore.

**Berat Duraku:** Atëherë, për shkak të kuotës gjinore, ne e ndërrojmë propozimin, e propozojmë Florida Bajraktarin.

**Kryesuesi:** Kërkoj që edhe nga PDK-ja të jetë femër.

**Flutura Thaqi:** Atëherë, ne propozojmë Melinda Oruqin.

**Kryesuesi:** Atëherë, duhet ta bëjmë një zëvendësim prej PDK-së, sepse mund të jetë konflikt interesi në aplikime.

**Melinda Iska-Oruqi:** Propozojmë Flutura Ukaj-Thaqin.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Meqë i kemi 4 emra, duhet t’i vendosim në votim një nga një. Kush është “për” Florida Bajraktarin?... Kush është “për” Dr. Qazim Cana?... kundër?... abstenim?... Kush është “për” Jusuf Dërmalën?... kundër?... abstenim?... Kush është “për” Flutura Ukaj-Thaqin?... kundër?... abstenim?... Atëherë, nga votat tuaja, Florida Bajraktari merr 14 vota pro, Qazim Cana 11 pro dhe 1 abstenim, Jusuf Dërmala 12 pro dhe 1 kundër dhe Flutura Thaqi 14 pro. Pra, Florida Bajraktari dhe Flutura Thaqi janë dy anëtare që do të përfshihen në këtë komision. E vendosim në votim pikën e rendit të ditës. Kush është “për”?... kundër?... abstenim?... Me 14 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, miratohet ky vendim.

**14. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 84/26, të datës 26.1.2026, për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete:**

**Kryesuesi:** Ne e kemi votuar këtë komitet në seancën e kaluar dhe MAPL-ja e ka kthyer si të kundërligjshme për shkak të kuotës gjinore. Tani e kemi ndryshuar dhe anëtare e re do të jetë Edonita Berisha. Nëse nuk keni diçka, po e vendos në votim. Kush është “për”?... kundër?... abstenim?... Unanimisht votohet ky vendim.

**15. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, P-71510033-00772, ZK-Xërxë:**

**Besmirë Bytyqi:** Në këtë pikë kemi të bëjmë për dhënie në shfrytëzim afatgjatë pjesën e parcelës në fshatin Xërxë. Komisioni, në mandatin e kaluar, e ka kryer, e ka dhënë në shfrytëzim. Ndërsa, këtu e kemi edhe raportin e komisionit, i cili thotë: Ky komision, pas hapjes së ofertave më datë 27 qershor 2025, konstaton që, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për këtë pronë, ka pasur vetëm një ofertues (person juridik). Pas vlerësimit të ofertave dhe plotësimit të kriterëve, komisioni e ka shpallur fituesin e ankandit publik për pronën e paluajtshme në fshatin Xërxë, në vendin e quajtur Gradish me kulturë kullosë e klasit të pestë, në sipërfaqe prej 2350m<sup>2</sup>, e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2000m<sup>2</sup> e evidentuar si pronë e komunës së Rahovecit. Fitues i këtij ankandi është Bes Franc LLC me përfaqësues z. Bashkim Bytyqi nga fshati Dejnë. Ai ka ofertuar prej 11 centë për m<sup>2</sup> dhe qiraja mujore është 258.5€.

**Jusuf Dërmala:** Cili është qëllimi i dhënies në shfrytëzim? Realisht, kjo punë është ndërtuar si obelisk dhe po ashtu është e destinuar si pjesë e ushtarëve të vrarë të UÇK-së. Nuk më duket që është shumë e logjikshme që tash ta japim në shfrytëzim këtë pronë. Kjo pronë është histori dhe është ndërtuar për këtë punë.

**Kryetari:** Ne po flasim për një pronë që është dhënë në shfrytëzim në vitin e kaluar. Para vetes e kemi raportin e përfituesit. Prona është dhënë për 20 vjet. Aty, absolutisht nuk cenohet kompleksi përkujtimor dhe dedikimi i kompleksit. Raporti ka ardhur për një vendim që është marrë vitin e kaluar (më 24 gusht bëhen 2 vjet), prandaj mos iu hyn lakrave, sepse nuk je i informuar. Historinë për të cilën flet, unë e njoh më mirë se ti edhe atë pa qenë fare kryetar, sepse unë kam qenë pjesë e asaj beteje në Gradish. Bëhet fjalë për një menaxhim dhe mirëmbajtje më efikase, duke zhvilluar një projekt investues, duke mos i prekur vlerat përkujtimore të kompleksit. Projekti është jashtë mureve, prandaj nuk ka hapësirë për keqkuptime dhe nuk ka arsye për keqinterpretime, sepse do të ketë raport për çdo pronë që jepet në shfrytëzim. Ky projekt që do të realizohet aty, do t’i japë shumë gjallëri atij vendi. Ka raste të tilla në Krujë e në Paris.

**Jusuf Dërmala:** Kryetar, nuk dua ta mohoj kontributin tënd në luftë, por nuk ke nevojë të ma tregosh as ti mua luftën, sepse e kam përjetuar edhe unë. Të gjithë e kemi përjetuar luftën dhe secilin në formën e vet. Te kompleksi, the që investimi është jashtë mureve, por në bazë të kësaj që unë po e shoh këtu, parcela është brenda mureve. The që kjo i rrit vlerat. Unë nuk e di se në cilat vende të botës ke parë memorialë që kanë brenda kafiteri apo restorante. Më vjen shumë keq, ky është destinim i gabuar.

**Kryetari:** Nuk mundet askush askujt t’ia mohojë vlerat e as të ia vërë në kontest. Unë tregova se kush jam, nuk thashë se kush je ti. Nuk u thirra në luftë unë, por thashë se, sa i përket flamurit e mbrojtjes së këtyre vlerave, unë e mbaj lart dhe gardën nuk e uli kurrë. Ta tregova Krujën dhe bash te muzeu etnografik ka piceri dhe disa herë kam hëngër pica aty, me shokë e me familje. Po ashtu, në Vjenë, te përkrenarja e Skënderbeut ka shitore dhe kafiteri. Ajo pronë tani për tani është e vdekur, sepse nuk shkon askush përveç kur ka ngjarje dhe me këtë projekt investiv, pa dyshim që do t’i rritet vlera, do të ketë më shumë dinamikë, ngjarje, atraksion dhe vizitorë.

**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! Meqenëse iu përmend emri, me rregullore të Kuvendit, Jusufi e ka të drejtën e replikës. Nëse nuk ka diskutues, atëherë unë kam diçka rreth këtij vendimi. Vendimi është marrë në gusht të vitit 2024. Në qershor të vitit 2025, komisioni e ka kryer punën rreth hapjes së ofertave dhe në shkurt të vitit 2026, është i vendosur protokoll. A jemi në rregull ligjrisht dhe proceduralisht?

**Afrim Oruqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të Kuvendit. Kuvendi i kaluar e ka marrë një vendim për ta dhënë me qira këtë parcelë. Sipas ligjit, pronat që jepen më shumë se 15 vjet, kthehen përsëri në Kuvend. Bashkë me mua dhe të tjerët, Defrimi ka qenë në komision. Pas këtij vendimi, i kemi zhvilluar procedurat e ankandit. I kemi hapur ofertat dhe ka qenë vetëm një ofertues. Në momentin kur përzgjidhet fituesi, bëhet një raport dhe nënshkruhet prej anëtarëve të komisionit dhe fakti që kjo pronë po jepet për 20 vjet, atëherë kthehet prapë në Kuvend. Përsëri i raportohet Kuvendit - institucionit që e ka marrë vendimin për këtë pronë. Kur ka përfunduar procedura e ankandit, ka ardhur një shkresë nga MAPL-ja, që duhet t'i ndërpresim të gjitha procedurat për shkak të zgjedhjeve lokale. Këto procedura i kemi ndërprerë dhe tutje procedurat kanë përfunduar. Tani, para vetes e keni raportin e komisionit të asaj kohe dhe po ju njoftojmë juve si kuvend i ri, që fatmirësisht, disa prej anëtarëve jeni përsëri, që e kemi pasur një ofertues, ky është ai, ky është destinimi dhe ky është çmimi. Përsëri, Kuvendi është ai që do të vendosë sot dhe pas votimit, kryetari e fton fituesin për nënshkrimin e kontratës. Unë si anëtar i komisionit dhe si jurist, ju them juve që ky komision e ka kryer punën sipas ligjit dhe ju ftoj që ta votoni vendimin. Të njëjtat veprime i kemi bërë te "Maja e Shkodranit".

**Lirigon Kastrati:** Unë për çështjen e dhënies në shfrytëzim nuk kam çka flas, por si procedurë e konsideroj si antiligjore. A e dini pse? - Nga momenti që shpallen zgjedhjet lokale, të gjitha komisionet e pezullojnë punën e vet, vetëm nëse ka mbetur nënshkrimi i kontratës dhe nëse ky raport ka kaluar para datës së shpalljes së zgjedhjeve lokale, si dhe kryetarit iu ka drejtuar për nënshkrim të kontratës, atëherë është i ligjshëm. Nëse komisioni i ka zhvilluar procedurat pas shpalljes së zgjedhjeve lokale, veprimet procedurale janë antiligjore.

**Afrim Oruqi:** Kur na është kërkuar që t'i ndërpresim procedurat, e kemi bërë menjëherë bashkë me Lirigzonin, atëherë kur i kemi zhvilluar procedurat për "Hotel Park Plazën". Janë ndërprerë të gjitha procedurat e tjera, në çdo vendim. Asnjë veprim tjetër procedural nuk është bërë në lidhje me këtë pikë dhe krejt procedurat kanë qenë të përfunduara: Janë mbajtur takimet, është hapur oferta, është shpallur fituesi, është nënshkruar raporti dhe Lirigzoni e di saktë që asnjë veprim i këtij komisioni nuk është bërë pas asaj shkrese nga MAPL-ja. Në fund, nëse jemi në gabim, këto vendime shkojnë në MAPL dhe nëse ata e vërejnë që ka gabime, atëherë vendimi nuk kalon. Ne nuk shtyjmë përpara vendime që mund të shfuqizohen, sepse Kryetari i Komunës humb pikë në vendime të shfuqizuara.

**Defrim Kafexhiu:** Vendimi është marrë më 29.10.2024 dhe të gjitha punët komisioni i ka përfunduar. Tani është vetëm raporti. Asnjë proces nuk ka rrjedhur, prej kohës kur janë shpallur zgjedhjet lokale.

**Lirigon Kastrati:** Defrim, është shumë e thjeshtë kjo, nëse ky raport do të votohej para shpalljes së zgjedhjeve lokale, kryetari, me të drejtë mund ta nënshkruajë kontratën. Nëse pas zgjedhjeve lokale, ju e keni hapur thirrjen dhe keni zhvilluar procedurat, atëherë ky është veprim antiligjor.

**Kryesuesi:** Faleminderit! Nuk ka diskutues të tjerë?... Nëse jo, vendimin po e vendos në votim. Kush është "për"?... kundër?... abstenim?... Me 24 vota "për" dhe 1 kundër, miratohet vendimi për dhënie në shfrytëzim.

#### **16. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025:**

**Skender Hamza:** Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Planin e Punës së Kuvendit, kemi kënaqësinë të paraqesim raportin 12-mujor lidhur me aktivitetet, punët dhe angazhimet e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, janar-dhjetor 2025. Ky raport ka për qëllim që të rritë transparencën dhe llogaridhënien e Kuvendit. Bazuar në këtë, Kuvendi i Komunës ka përmbushur obligimin ligjor sipas nenit 43 pika 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku në periudhën janar-dhjetor, ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje të rregullta, 1 solemne, 1 urgjente dhe 1 inauguruese. Kuvendi, po ashtu, i ka pasur të themeluara edhe komitetet obligative dhe konsultative. KPF-ja: 10 mbledhje; Komiteti për Komunitete i ka mbajtur 5 mbledhje; Komiteti për Arsim: 1 mbledhje; Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i ka mbajtur 4 mbledhje, njëjtë edhe Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara, si dhe KKSJ-ja: 5 mbledhje. Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në vitin 2025 i ka miratuar 50 vendime, 2 plotësim-ndryshime të rregulloreve, 17 raporte dhe 14 informata.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit shumë, Skender, për këto sqarime për raportin e punës së Kuvendit për 2025! Të falënderoj në emër të grupit të LVV-së, si Sekretari e Kuvendit dhe respekt për punën! Në vitin e kaluar, në planin e punës së Kuvendit, e kemi pasur një vizitë studimore, por që nuk është realizuar. Shpresojmë që ky vit do të jetë më i mbarë në këtë aspekt, me kryesuesin e ri.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Defrim! Vizitën studimore, patjetër, veç duhet ta gjejmë formëm. Nëse edhe dikush ka diçka rreth raportit të punës së Kuvendit? Nëse jo, kalojmë në pikën e 17-të.

#### **17. Shqyrtimi i informatës së KKSBB-së për vitin 2025:**

**Kryetari:** Janë mbajtur 5 mbledhje të KKSBB-së, ka mundur të mbahet edhe e gjashta, por qëlluan zgjedhjet lokale. Në KKSBB, e dini se kush kë e përfaqëson, prej policisë, FSK-së, shoqërisë civile, bizneseve, komunës, bashkësive fetare. Një ndryshim nga viti 2024 në 2025 është që mbledhjet e KKSBB-së i kemi mbajtur përtej qytetit, një në Krushë të Madhe dhe një në Ratkoc. Epiqendra e aktiviteteve të KKSBB-së është siguria. Në muajin mars, do ta keni planin vjetor të KKSBB-së për vitin 2026.

**Lirigzon Kastratin:** Faleminderit, kryesues! Faleminderit kryetar, për këtë raport! E the që janë diskutuar tema të sigurisë. Vitin e kaluar e kemi pasur një shqetësim, sidomos me çështjet e zjarrvënieve. A i keni diskutuar këto çështje në KKSBB dhe a e keni ndonjë plan rreth menaxhimit të këtyre ndodhive?

**Kryetar:** Po, sidomos kur fillon kjo periudha e ngritjes së temperaturave. Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, edhe pse nuk ka ndonjë kompetencë të plotë në menaxhimin e zjarrfikësve, sepse ju e dini që zjarrfikësit menaxhohen nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (Ministria e Punëve të Brendshme). Ne i marrim disa hapa: Paralajmërime, sensibilizim, porosi. Pikë standarde në KKSBB është çështja e zjarreve. Jemi duke e bërë një plan të ri, që ka të bëjë kryesisht me AME-në, që ndërlidhet me zjarrfikësit, me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, si dhe me policinë.

#### **18. Shqyrtimi i kërkesës së Kompanisë Regjionale për Mbeturina “Ekoregjioni”, për ngritjen e tarifës së shërbimit të mbeturinave:**

**Përparim Krasniqi:** Para jush e keni një kërkesë nga kryeshefi ekzekutiv i KRM “Ekoregjioni”, për ngritjen e tarifës së shërbimit të mbeturinave – ekskluzivisht për amvisëri. Në qoftë se e keni lexuar kërkesën, aty shkruan që të rritet tarifa prej 5.5 në 6. Kuvendarë të nderuar, në vitin 2023, Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me “Jaica japoneze”, e ka kaluar rregulloren dhe Komuna e Rahovecit e ka ngritur këtë tarifë, prej 5.5 e ka bërë në 6. Një rekomandim nga ky Kuvend duhet të jetë që për plotësim-ndryshim të rregullores janë disa procedura, pra, hidhet në diskutim publik. Prandaj, kërkoj që kjo pikë të shtyhet.

**Kryetari:** E kuptojmë që është rritur kostoja e jetës dhe inflacioni, përveç pagave. Mos ta harrojmë këtë fakt, në të ardhmen, Kuvendi i Komunës duhet ta bëjë plotësim-ndryshimin e rregullores. Sot, duhet ta diskutojmë këtë pikë, sepse kërkesës duhet t'i përgjigjemi me saktësi. Mirëpo, sot nuk vendosim asgjë, sepse i shkelim disa parakushte të diskutimit publik. Këtë kërkesë e vlerësoj si të drejtë dhe legjitime, sepse është rritur gjithçka rreth çmimeve. Këtu e kemi Tolën, që është përgjegjës për njësinë në Rahovec dhe besoj që ia përcjell këtë diskutim kryeshefit. Sot jemi duke e shqyrtuar dhe tutje duhet të vendosim se me çfarë tarife do të shkojmë, me 6, 7 apo 8. E ftoj Përparimin që ta bëjë konceptin për diskutim publik.

**Lirigzon Kastrati:** E mbështesim propozimin e drejtorit që më e udhës është fillimisht të diskutohet, sepse vendimi i ngutshëm dhe mund të ketë impakt jo të mirë te qytetarët. Me vetë faktin që jemi komuna e vetme që i kemi tarifën më të larta, konsideroj që duhet t'i shtjerrim të gjitha mundësitë dhe të respektohet rregullorja. Te arsyetimi i kërkesës së kompanisë, unë besoj që është pak i mangët, me vetë faktin që thotë që kemi rritje të çmimit të naftës. Ne e dimë që në Kosovë çmimi i naftës është më i lirë në rajon, kështu që, e mbështesim idenë që kjo pikë të shtyhet.

**Mentor Veliu:** Përshëndetje për të gjithë! Lirigzon, në deponi në Landovicë, në vitin 2023 nëse nuk gabo, kanë marrë vendim që automatikisht më 1 janar të rritet çmimi për ton në 7€ dhe në secilin vit pasues nga 1€ për ton. -

Pse kemi dallime me Prizren? - Sepse deponia e Landovicës është shumë më afër Prizrenit sesa e Rahovecit. Në Suharekë kanë pasur probleme politike për shkak të tarifave dhe për shkak të numrave në Kuvend. Te ne është shtuar volumi i punëve dhe unë që 2 vjet kam filluar të praktikoj edhe pastrimin e rrugëve regjionale, që ligjërisht janë në përgjegjësi të ministrive. U mundova ta jap një sqarim njerëzor dhe sa u përket pagave kemi premtime që me rritjen e çmimeve do të rriten edhe pagat. Nuk e kam hallin tim, por të punëtorëve, sepse një punëtor fizik te ne e ka rrogën 400 e pak euro. Shoferi i kamionit me kategori C e ka 500 e pak euro dhe në tregun tonë sot, nuk ka shofer me kategori C me 500 € pagë.

**Lirigzon Kastrati:** Në vitin 2023 the që i kemi rritur tarifat për shërbimin e mbeturinave dhe shefi i grupit Burim Krasniqi ka kërkuar që kjo rritje të ketë impakt në pagat e punëtorëve. Nëse keni informacion, sa janë rritur pagat në vitin 2023, kur e kemi pasur këtë ngritje të çmimit të mbeturinave?

**Mentor Veliu:** Ndoshta mund të gaboj në vlera, por ka pasur ngritje. Ngritje ka pasur dy herë dhe në seancën e radhës mund t'ju dokumentoj edhe me letra. Pagat në atë vit kanë qenë 300 e pak euro, sot janë 400 e pak euro.

**Defrim Kafexhiu:** Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që këtë vendim dhe këtë ndërmarrje, nuk bën ta shohin si diçka private, është ndërmarrje publike dhe me rritjen e çmimit nuk i shkon përshtati "pronarit" të ndërmarrjes, por kompanisë publike. Në KPF e kam kërkuar edhe vendimin e ministrisë, sepse kërkesa nga kryeshefi nuk ka qenë mirë e përpiluar dhe në vendimin e ministrisë thotë që vitin tjetër çmimi shkon deri në 11€ për një ton për në deponi. Parimisht unë jam kundër të rritet, sepse qytetarëve iu rritet kostoja e jetesës. Duke marrë parasysh që i vetmi shërbim që varet prej Kuvendit (tarifa e mbeturinave), sepse kur të na rritet çmimi i energjisë elektrike, askush nuk na pyet. E thashë, parimisht unë jam kundër të rritet, por duhet ta shikojmë edhe te këndvështrimi i kualitetit të shërbimeve. Nëse vazhdon kualiteti i shërbimeve të jetë i mirë, atëherë jemi në rregull dhe qytetarët do të pajtohen me këtë rritje. Pajtohem gjithashtu, që këto hapa duhet t'i marrim pas diskutimeve publike dhe kjo rritje të ketë impakt në rritjen e pagave të punëtorëve të ndërmarrjes.

**Kryetari:** Në fillim e thashë që kërkesa është legjitime, sepse është rritur edhe kostoja e operimeve të Ekoregjonit. Parimisht, unë së pari jam pro rritjes së pagave, rritjes së kualitetit të jetesës dhe rritjes së investimeve të kualitetit të mjedisit. Mirëpo, që të vijmë te kjo pikë, duhet t'i respektojmë procedurat dhe të organizojmë debate publike. Pas përfundimit të debateve publike, supozojmë në muajin maj mund të jetë në rend dite kjo pikë dhe kur e ngrini dorën për votim, e ngrini me vetëdije dhe me arsye. Unë, parimisht jam pro rritjes së pagave dhe tutje pro rritjes së tarifës.

#### **19. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:**

**Nehar Shala:** Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit, kryesues! I nderuari kryetar, kolegë kuvendarë, drejtorë të drejtorive! I kam tri çështje, të cilat lidhen me fshatin Krushë e Madhe. Kryetar, çështja e parë është problemi me energjinë elektrike. E di, jeni të informuar për shkyçjet që kanë ndodhur dhe që po ndodhin në vazhdimësi. Për dallim prej fshatrave të tjerë, Krusha akoma vazhdon të jetë e lidhur me nënstacionin e Piranës. E kuptoj që ndoshta kjo punë mund të mos jetë përgjegjësi direkte e Kryetarit të Komunës, por gjithashtu e kuptoj shumë mirë që me autoritetin që keni, besoj që mund të ndërmerri hapa në këtë drejtim, ta bëni një zgjidhje, sepse faktikisht gjendja momentale po krijon shumë pakënaqësi te banorët. Çështja e dytë është çështja e Muzeut të Masakrës. I kemi marrë disa kritika që muzeu qëndron i mbyllur për vizitorë. Kemi marrë kritika edhe nga kryetari i fshatit dhe ankesa nga grupet që kanë pasur interesim ta vizitojnë muzeun dhe në kohë të caktuar nuk e kanë realizuar vizitën, sepse muzeu ka qenë i mbyllur. Çështja tjetër ka të bëjë me qentë endacakë. Mbrëmë është bërë publike në faqen e Krushës së Madhe, ku një prind është ankuar që për shkak që detyrohet ta dërgojë fëmijën e tij në çerdhe, lart atje në këmbë, ka thënë që rrezikohet shumë nga qentë endacakë që gjenden në atë zonë.

**Kryetari:** Nehar, unë tani do të lëviz për Prishtinë, sepse një shok i imi kthehet në Hagë për gjykim për 7-8 ditë, por të premtoj që për këto tema do të bisedoj me KEDS-in, do të bisedoj edhe për nënstacionin, si dhe përgjigje mund të të jap edhe për Muzeun e Masakrës. Aty në punë është vetëm një djalë dhe ndonjëherë pushon, por sot

më kurse, sepse po shkoj. Çështje më e ndejshme është kjo e qenve endacakë. Gjithashtu, edhe unë jam i pakënaqur me numrin e qenve endacakë. Do të përgjigjem specifikiisht në çdo pyetje.

**Nehar Shala:** Po më vjen keq që tash po përmendet edhe ai djali, sepse e njoh edhe personalisht, është shumë djalë korrekt dhe i mirë. Çështja është që kam pasur ankesa që nuk kam pas “qare” pa i folur.

**Vlora Vuçiterna – Çmega:** Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, kryetar, nënkryetar dhe të gjithë ju që po na ndiqni! I nderuari kryesues, faleminderit për fjalën e dhënë! Kësaj here nuk kam pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, por dua t’i bëj dy propozime konkrete. Propozimi i parë: Në hyrje të QKMF-së, pranë barnatores, të vendoset një ekran informues si lloj projektori, ku do të paraqitet lista e barnave esenciale të cilat janë në dispozicion. Ekрани duhet të përditësohet çdo ditë, me të dhëna të sakta. Kjo gjë do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e transparencës ndaj qytetarëve, si dhe në përmirësimin e informimit të pacientëve, lidhur me barnat që ata mund të furnizohen. Propozimi i dytë: Duke marrë parasysh nevojën për mbështetje institucionale për fëmijët me autizëm dhe sindromin down, si dhe duke shënuar rritjen e përfshirjes sociale dhe sadopak lehtësimin e barrës ekonomike, propozoj që komuna ta shqyrtojë seriozisht këtë çështje. Meqenëse data 2 prill është Dita Botërore për Fëmijët me Autizëm, propozoj që këtë muaj, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale t’i mbështetë këta fëmijë në shumën me vlerë prej 100€, ndërsa për fëmijët me sindromin down, nëse nuk është e mundur që kjo të realizohet në muajin prill, të bëhet në nëntor, muaj ky që simbolizon sindromin down. Në një rën nga ojq-të në Rahovec, numri i fëmijëve të regjistruar me sindrom down është 8, ndërsa me autizëm 3. Në ojq-në tjetër, të regjistruar për afërsisht janë 3 me autizëm dhe 5 me sindrom down, ndërsa në një rën nga ojq-të, nuk kam arritur të marr të dhëna. Në total, numri i tyre sillet në 30-40 dhe nëse e kalkulojmë i bie që 3000€ në vit të ndahen nga komuna për përkrahje të këtyre fëmijëve. Besoj që dëshira jo vetëm e imja, por e të gjithë kuvendarëve këtu është që t’i mbështesim këta fëmijë për çdo muaj, por në mungesë të mjeteve, t’i ndihmojmë së paku në muajt që simbolizojnë datën për ta. Propozoj që, propozimin tim të dytë ta vendosim në votim dhe pa dallime politike, kërkoj përkrahjen tuaj.

**Kryetari:** Ne duhet ta shqyrtojmë këtë propozim me drejtorin për Buxhet dhe Financa. Absolutisht nuk jam kundër kësaj ideje, por nuk ka nevojë të vendoset në Kuvend. Ne mund ta vendosim si prioritet. Kjo nuk është çështje për Kuvend, sepse nesër dalin ata që janë daltonistë dhe kategoritë e tjera të cilat duhet t’i trajtojmë me respekt (me autizëm, me fibrozë etj.). Ata mund të aplikojnë tani, si ojq dhe individualisht dhe pas alokimit të buxhetit për komuna mund të bëjmë diçka. Por, për ta vendosur si standard këtë mbështetje, atëherë duhet ta planifikojmë me buxhet për vitin e ardhshëm.

**Kryesuesi:** Faleminderit, kryetar! Nëse jo më 2 prill, atëherë shqyrtojeni këtë mundësi në nëntor.

**Flutura Thaqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për ty, për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive dhe kolegët asamblistë! E kam një kërkesë në emër të fshatit Dobidol. Komuna të ndërhyjë në rregullimin e kanalit kullues, afër shkollës. Në këtë kanal paraqiten probleme, sidomos gjatë reshjeve të shiut dhe rrezikon nxënësit. Kërkoj që kjo çështje të merret parasysh dhe të futet në planin e punëve për këtë vit. Kërkesa tjetër ka të bëjë me rregullimin e trotuarit deri në fund të fshatit Dobidol.

**Hazbije Shala:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje, kryesues, drejtorë, kolegë asamblistë! Ditëve të fundit është vërejtur një numër i madh i qenve endacakë në qendër të qytetit, veçanërisht në zonën e sheshit në ndërtim, ku qarkullimi i qytetarëve është i lartë. Ka pasur raste të sulmeve ndaj qytetarëve, sidomos ndaj të moshuarve dhe fëmijëve, gjë që paraqet rrezik serioz për sigurinë publike. Kërkoj nga kryetari dhe drejtoritë përgjegjëse, që të marrin masa urgjente për trajtimin e këtij problemi.

**Bujar Mustafa:** Përshëndetje për të gjithë. Kryetari tha mos ma lakoni emrin, por dy herë m’u drejtua mua, tha: “qentë endacakë” dhe më ndjelli mua. Problemi është që qentë endacakë janë të komunës dhe jo të veterinarit. Unë këtu jam në cilësinë e përfaqësuesit të LVV-së dhe nuk mund të flas në emër të operatorit ekonomik që e ka kontratën, por në cilësinë e një eksperti mund ta jap një sqarim për këtë problemin e qenve endacakë. Problemi i

qenve endacakë, jo vetëm në komunën tonë, por në nivel Kosove, nuk e ka bazë vetëm qenin endacak, por edhe pronarin e qenit. Pronarët janë mbajtës të pandërgjegjshëm dhe i humbin. Komuna jonë, në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, vazhdimisht ka pasur projekte për trajtimin e tyre. Projekti i tillë nuk do të thotë që e zgjidh problemin komplet, sepse është i përkohshëm. Ky problem kërkon një trajtim më të madh, jo vetëm prej komunës por edhe prej qeverisë. Të bëhet regjistrimin i qenve me pronarë.

**Behlul Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Të nderuar drejtorë, kolegë asamblistë! I kam disa pyetje për tri drejtori. Për drejtorin e DKA-së: Shkolla e fshatit Senoc (mbi 100 nxënës), në të cilën prej vitit 2006 nuk është investuar asgjë dhe paramendojeni, gropa septike e kanalizimit është veç 2 metra larg shkollës, kanalizimi nuk ka lidhje dhe në momentin që rriten temperaturat aty kundërmon. Shkolla nuk ka ujë as për pije. Që nga viti 2006 kur kjo shkollë është ndërtuar nga një kompani gjermani, prej asaj kohe asnjëherë nuk është investuar. Vlen të ceket që ne nuk jemi shkollë e pavarësuar, por jemi paralele e shkollës “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc. Shkolla është në gjendje të tmerrshme. Fusha e futbollit po ashtu është tmerr, gjendja e shtyllave të golave janë bërë të rrezikshme për nxënësit. E kam një pyetje edhe për drejtorin e Shërbimeve Publike: Kryetari e tha që është viti i 11 që është në pushtet. Do të thotë që 11 vjet, mandati i katërt dhe asnjë investim nuk është bërë në fshat e sidomos në rrugë. Ka 4 vite që ka mbetur një rrugë të shtrohet, ka ardhur një kompani nga Suhareka ka punuar dy ditë në rrugën që është afër odes së fshatit. Në atë kohë kemi dalë me traktor, e tani as me traktor nuk mund të kalojmë për shkak të gurëve. Cila është arsyeja pse në këtë fshat nuk punohet? Apo që nuk ka pasur ndonjëherë asamblist? Tjetra është për drejtorin e Bujqësisë, tani është i ri, por pyetja i takon ish-drejtorit. Janë shtruar disa rrugë në muajin korrik 2025, ende pa kaluar 20 makineri bujqësore, ajo rrugë është dëmtuar. Në këtë rast kujt i mbetet përgjegjësia?

**Berat Duraku:** Faleminderit, kryesues! Dua të ndërlidhem për temën e qenve endacakë, e cila veçse u diskutua këtu. Kolegu ynë nuk e përmendi që komuna jonë vazhdimisht ka pasur kontratë për trajtimin e qenve endacakë. Komuna e Rahovecit prej vitit 2018 vazhdimisht ka pasur kontratë për trajtimin e qenve endacakë, por ligji aplikativ që është në Kosovë i ka kufizimet e tij dhe që na vazhdueshëm do të kemi qen endacakë. Na duhet një ndryshim ligjor dhe të funksionalizohen qendrat strehimore për grumbullim. Sa i përket pyetjes së kolegut Behlul, për këtë i përgjigjet drejtori i ri.

**Sali Sallteku:** Faleminderit, kryesues! E di që jeni lodhur pak, e thash t’ju bëj me qeshë. Të gjithë kërkuar diçka, edhe unë po kërkoj diçka për fshatin Radostë. Pyetja është për drejtorin e Arsimit. Kërkesën e kemi bërë moti. Qentë endacakë e kanë mbushur oborrin e shkollës, i cili ka nevojë për rrethoja. Drejtor, do të ishte mirë ta marrësh këtë përgjegjësi.

**Defrim Kafexhiu:** I kam disa çështje: Çështja e parë është trafoja në lagjen “Vëllezërit Frashëri”, mezi në fushatë zgjedhore është bërë zgjidhja. T’ia japim këtu disa merita Mentor Veliut, asambleistit të Aleancës, i cili ka dhënë kontribut dhe ka bërë zgjidhje për atë trafo. Ka mbetur vetëm funksionalizimi. Ku ka mbetur si proces dhe kur pritet të përfundohet? Për drejtorin e Shërbimeve Publike: Ka nevojë për policë të vdekur, sidomos në rrugë ku ka shkolla. Më ke thënë që keni kontratë aktive dhe besoj që policë të vdekur duhet të vendosni në të gjitha rrugët kryesore ku janë shkollat afër. Një çështje tjetër që besoj që duhet të ngritet në KKSB, në koordinim me stacionin policor në Rahovec, rreth parkingut të veturave nëpër trotuare të rrugëve kryesore, të cilët janë pengesë shumë e madhe për këmbësorë. Ndoshta policia duhet të fillojë fillimisht me vërejtje për të gjithë ata që e parkojnë veturën e tyre në trotuar për një kohë të gjatë. Një çështje tjetër për një debat që ka qenë publik, rreth një vendimi të Komisionit për Buxhet dhe financa në kuadër të kuvendit të Kosovës dhe që kanë dalë disa lajme të pavërteta kinse janë refuzuar disa amandamente për komunën e Rahovecit. Më pastaj janë sqaruar, ku ka dalë edhe kryetari me një postim. Këtë punë dëshiroj t’ia sqaroj një kolegut tim të LDK-së, i cili është tendencioz dhe jo mirë i informuar dhe i cili nuk është këtu. Ai ka shpifur me postimet e tij në facebook, kinse ky komision i ka refuzuar projektet për komunën e Rahovecit, projektet që janë të buxhetuara dhe që pritet të fillojnë, si dhe do të realizohen brenda këtij

mandati. Janë edhe 5 amendamente të tjera, që Komuna e Rahovecit i ka bërë si kërkesë në kuadër të komisionit, për të cilat do të bëjmë çmos që të aprovohen.

**Yllka Shehu:** Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Të nderuar drejtorë të drejtorive, kolegë asamblistë. E kam një shqetësim në lidhje me shtëpinë e kulturës. Është pak shqetësues fakti që aktivitetet aty janë shumë të rralla dhe padyshim është shqetësues fakti që të rinjtë tanë detyrohen që këto atraktivitete t'i gjejnë në qytete të tjera të Kosovës. Për Drejtorinë e Kulturës: Cili është plani konkret për funksionalizimin e plotë për shtëpinë e kulturës brenda këtij viti dhe a ka buxhet të planifikuar për aktivitetet kulturore brenda këtij viti?

**Mentor Veliu:** Dua t'i përgjigjem këtij kolegut të Vetëvendosjes, se këta e kanë primatin e mirë për shpifje dhe propaganda. Sa i përket çështjes së trafos, për që e ka ngrit këtu kolegu ynë Defrimi, ajo trafa nuk ish bë edhe 100 vjet. Njeriu lind për komunitetin, jo përmes postimeve në facebook me propaganda, por nëse janë qëllimet e mira unë do të jem përkrah teje, jo veç për trafa, por për çdo të mirë tjetër të këtij vendi. Trafaja do të bëhet, sepse e kam përkrahjen e kryetarit dhe drejtorit. Une e di si e kam bindur zotërinë aty, sepse ajo është pronë private. Defrim, ti bile je më afër në atë lagje, sesa unë dhe je shumë i njoftuar për këtë çështje. Jo propaganda në facebook, por vetëm me gjëra konkrete.

**Defrim Kafexhiu:** Nuk të kuptova shumë mirë se çka the me këtë, por unë i qëndroj prapa çdo gjëje që e kam publikuar. Nëse mendon që kontribuon më shumë se dikush tjetër, kjo nuk ia mohon kontributin dikujt tjetër. Secilin në formën e tij, pavarësisht si e sheh ti ose qytetarët. Me më quajt propagandues nuk e lejoj, sepse nuk jam. Unë vazhdimisht në 4 vitet e kaluara kërkesë kam bërë, diçka tjetër nuk mund të bëjë, duke u bazuar në kompetencat e anëtarit të kuvendit. Propagandë nuk kam bërë, meritat t'i dhashë për trafa. Unë nuk kam pasur mundësi ta gjej një njëri për pronë, sikurse e ke bërë ti, që ke ra në ujdi. Unë për 4 vjet, pothuajse në çdo të dytën seancë jam marrë me atë çështje përmes kërkesave. Unë vetëm e bëra pyetje, pse ende nuk është funksionale? Çdo herë mundohem të jap kontribut edhe kur nuk dal në foto, ose me video-incizime, me takat, dikush më shumë e dikush më pak.

**Kryesuesi:** Mentor - Defrim, ju lus që diskutimet që i keni le të jenë të sqarta dhe në interes të qytetarëve.

**Sali Sallteku:** Nuk e konsideroj që ta zgjasim më shumë, sepse jemi lodhur. E vazhdojmë nesër, nëse dëshironi.

**Kryesuesi:** Veç për sqarim: Secili anëtar i kuvendit komunale ka dhënë betimin këtu, i cili nuk lidhet as me orar, as me ditë e datë të caktuar. Ata që janë lodhur, me leje Sali lirisht mund të shkosh, sqarohet po ta them. Nëse ka nevojë, diskutimet këtu duhet të vazhdojnë edhe pas mesnate.

**Flutura Thaqi:** Ne e pritem vetëm përgjigjen nga drejtori i Shërbimeve Publike.

**Kryesuesi:** Përgjigjet jepen në dy forma, me gojë dhe shkrim. Sekretaria e kuvendit i regjistron pyetjet e secilit kuvendar.

**Atdhe Rama:** Faleminderit, kryesues! Yllka, faleminderit për pyetjen. Shtëpia e kulturës është në funksion. Vetëm për vitin 2026 si drejtori për Kulturë i kemi pasur 2 aktivitete, për nder të "Flakës së Janarit" dhe e dyta për nder të festës së Pavarësisë së Kosovës. Kemi edhe shumë shoqata kulturore që operojnë në komunën tonë, të cilat po bëjnë shfaqje të ndryshme në shtëpi të kulturës dhe ne si drejtori e kemi një Plan Vjetor të Punës, të cilin do ta zbatojmë në përpikëri. Gjithashtu, besoj që shumë shpejt do të dalim në objektin e ri, në Qendrën për Kulturë, Art e Inovacion. Në vitin 2025, Komuna e Rahovecit ka ndarë 65.000€ subvencione vetëm për kulturë.

**Muhamet Morina:** Faleminderit, kryesues! I nderuar z. deputet, Krasniqi, i dëgjova pyetje tuaja me shumë vëmendje dhe vërtetë është për t'u shqetësuar, sepse jo vetëm objekti i shkollës suaj, por ka disa objekte shkollore që kanë nevojë për renovim të mirëfilltë, prej fillimit e deri në çati. Problemi ka qenë te mundësitë buxhetore. Sa i përket kërkesës tuaj, paraprakisht bashkë me drejtorin e Financave i kemi diskutuar këto gjëra dhe prioritet në planin e ri të prokurimit është edhe objekti i shkollës në Senoc, bashkë me punët që duhet të kryhen te kanalizimi dhe punët e tjera përcjellëse. Së shpejti inxhinieri i operatorit të kontraktuar del në terren dhe i merr masat për objektin tuaj. Gjithashtu, e njëjta gjë vlen edhe te pyetja e deputetit Sallteku. Rrethoja e shkollës në Radostë është

futur në planin e prokurimit dhe do të bëhet 100%. Kam dëshirë që sot t'i përgjigjem edhe z. Kastratit. Pyetja e parë e z. Kastratit ishte që ku janë shkollat në të cilat mungojnë kuadrot deficitare: Matematikë, fizikë dhe lëndët e tjera.

**Kryesuesi:** Muhamet, këtë çështje e kemi lënë si pikë të rendit të ditës në muajin mars.

**Muhamet Morina:** Atëherë në rregull, por për këtë çështje i kam shkruar edhe deputetëve të parlamentit të Kosovës që vinë nga Komuna e Rahovecit.

**Përparim Krasniqi:** Te pyetje e Fluturës për çështjen e kanalit: Flutur, për investimet e reja bëhen planifikimet buxhetore, prej diskutimeve publike në gusht dhe përfundon në shtator me miratimin e buxhetit, si dhe në këtë rast vitin që vjen bëhet investimi. Kjo periudhë që e keni bërë kërkesën ju, është periudhë që vetëm nëse fitojmë grante, atëherë e marrim kërkesën tuaj dhe e fusin në projekt. Te Behluli: Po, është e vërtetë! Te çështja e ndërtimit të rrugëve i kemi pasur dy rrugë, te lagjja "Morina" dhe te pjesa e odës së fshatit. Fatkeqësisht kompania "Gashi" e ka ndërprerë kontratën, jo për fajin tonë, por për atë që ATK-ja e ka mbyllur dhe si operator ka dështuar. Fat i mirë është që kanë filluar punimet 22 km, prej Saroshit deri në Rahovec dhe kompania "Lika" është duke e trajtuar rrugën kryesore dhe në kuadër të rrugës kryesore i kemi futur edhe disa elemente të rrugëve brenda fshatit. Besoj që këto dy rrugë, gjatë këtij viti do t'i trajtojmë me kujdes. Te trafoja: Është e vërtetë që, kryetari, Mentori edhe unë kemi qenë shumë të angazhuar në këtë drejtim dhe i kemi zgjidh problemet aty, sepse nuk është vendosur veç trafoja, është vendosur edhe rrjeti në pronë private deri te stacioni kryesor. Sipas KEDS-it është një problem, linja që do të lidhet aty është e një operatori privat dhe nuk po lejon të kyçet aty. Tani Keds-i e ka marrë përsipër dhe duhet që në rrugën "Agim Çelaj" të bëhet një gropim i ri rreth 330m dhe tutje të bëhet kyçja direkte me tensionin e lartë.

**Bujar Mustafa:** U mundova ta jap një sqarim të shkurtë për punën e qenve endacakë, por dua ta jap më të detajuar. E përmenda që vazhdimisht ka pasur projekte nga komuna, të llojit trajtim dhe lëshim në vendin e kapur që ka viti 2021. Trajtimi i qenve endacakë është projekt "Kastrim dhe Sterilizim" dhe bëhet lëshimi në vendin e kapur. Eutanazia lejohet vetëm nëse është qeni i sëmurë nga një sëmundje që kushton për t'u trajtuar, ose është shumë agresivë. Operatori ekonomik vazhdimisht e ka kryer punën edhe pse ka pasur vonesa të mëdha me pagesa prej komunës. Berati i përmendi strehimoret. Qendrat apo strehimoret për grumbullimin e qenve endacakë nuk bëhet, sepse menaxhimi ka kosto të madhe dhe e vetmja zgjidhje mendohet që është projektet e këtij lloji "Kastrim dhe Sterilizim", si dhe obligimi i pronarëve që qentë e tyre t'i regjistrojnë dhe t'i trajtojnë. Po ashtu, monitorimi i situatës dhe mbikëqyrja, të dënohet pronari që e hedh qenin.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Bujar! Për fund, ju informoj dhe ju ftoj të gjithë juve që përvojën e punës ta bëni gati në formë të vërtetimeve (nxjerrjen e trustit), për ta dokumentuar atë dhe të futet në listën e pagave, duke e marrë edhe një vlerë pagese shtesë që ju takon prej përvojës së punës, pa marrë parasysh në cilido institucion që punoni. Disa kuvendarë, duke e përfshirë edhe veten që kemi marrë page të shtetit, automatikisht na kanë pranuar përvojën e punës dhe mbi bazën e viteve e marrim 0.25%. Ju inkurajoj që t'i drejtoheni Agron Thaqit, shefit të personelit. Për moment me përvojë të pranuar jemi: Unë, Besniku, Saranda, Saliu dhe nuk e di për të tjerët. Ju falënderoj për kontributin, shihemi në takime të tjera.

Procesmbajtësi:

  
Albion Krasniqi



KRYESUESI

  
Fatmir Iska

